

L I G J
Nr.7860, datë 28.9.1994

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7805, DATË 16.3.1994 “PËR TATIMIN MBI
PASURINË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në ligjin nr.7805, datë 16.3.1994 “Për tatimin mbi pasurinë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përjashtimisht për vitin 1994, nga shuma e arkëtuar e tatimit mbi pasurinë për çdo komunë, 4 për qind e shumës së mësipërme mbetet në dispozicion të komunës për t’u përdorur: 2 për qind në formë shpërblimi për punonjësit e njësuar si agjentë tatimorë në komunë dhe 2 për qind për investime për nevojat e vetë komunës.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.941, datë 17.10.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha